



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:137905

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05507268

**P.nr.1963/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit M. D. nga P., i akuzuar për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3022/2020 të datës 19.10.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 11.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe i akuzuari M. D., me datë 11.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari M. D., i biri i M. dhe e ëma N. e gjinisë D., me vendbanim në rrugën “H. K.” në P. Lagja T..., I lindur me datë ..... në P..., me numër personal ..... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Më datë 08.03.2020, rreth orës 00:25, në rrugën nacionale P.-P. saktësisht në fshatin V. Komuna e F. K. i pandehuri deri sa ishte duke drejtuar automjetin e tije M., ngjyre e zezë me targa 01...-..., në kundërshtim me nenin 233 par 2 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.05/L-088, nën ndikimin e alkoolit me (0.77g/kg) në gjake me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë, duke shkaktuar aksident në komunikacion i cili ka rezultuar me dëme materiale.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 371 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit e gjykon me:

**DËNIM ME GJOBË**

- I. Në shumën prej 400.00 (katërqind) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3022/2020 të datës 19.10.2020, ndaj të akuzuarit M. D. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe të pandehurit M. D. ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit M. D. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par 1 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën qe e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 43 te KPRK-se te akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.1963/20 datë 26.03.2024**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.